



GTS

**SUBJEKTI “GTS – GAZRA TEKNIKE SHQIPETARE SH.P.K.”
NR. NIPT: J61905015B**

Prot Nr. 231

Tiranë më, 07. 06. 2016

KËRKESE

DREJTUAR: Ministrisë së Mjedisit.

LENDA: Njoftim për fillimin e procedurës së VNM Thelluar.

Shoqëria GTS “Gazra Teknike Shqiptare” Sh.p.k është themeluar ne vitin 1996. Ajo është anëtare e grupit multinacional SOL S.p.A e cila është e pranishme në 21 vende të Evropës, se fundmi Turqi dhe Indi.

Prodhimi i këtyre gazrave është konform të gjitha standarteve evropiane dhe ISO 9001:2008. Kerkojme nga ana juaj fillimin e procedures së VNM-së Thelluar e cila është bashkangjitur kësaj kërkesë.

Ju faleminderit,

Administratori

“GTS” sh.p.k.

Giovanni Annoni



Gazra Teknike Shqiptare Sh.P.K

Kombinat, Vaqarr

Tirane

t +3554350981

f +3554352877

m info@gts.al

www.solworld.com


Nipt: J61905015B

Kod.Fisk 3705095

Nr. Regj. 13637

SOLGROUP
a breath of life



 Qendra Kërkimore per ZHvillim Rural		
SUBJEKTI:	G.T.S.Sh.p.k	
AUTORI:	Qendra Kërkimore për Zhvillim Rural (RCRD)	
TITULLI PROJEKTIT:	Prodhimit dhe Amballazhimin E Dyoksidit të Sqfurit (SO₂)	Rev: 00
Titulli Dokumentit:	RAPORTI TEKNIK, INFORMACION I NDERVEPRIMIT ME MJEDISIN	





**PROJEKT PËR VNM Thelluar: Prodhimit dhe Amballazhimin e
Dyoksidit të Sqfurit (SO₂)**

VENDODHJA: Vaqarr, VAQARR, TIRANË

KËRKUESI:

SUBJEKTI “GTS – GAZRA TEKNIKE SHQIPETARE SH.P.K.”

NR. NIPT: J61905015B

	Qendra Kërkimore për Zhvillim Rural		SUBJEKTI
	Autor 1	Autor 2	Investitor
Emri/Firma	Prof. Dr. Sulejman SUIÇE 	MSc. Erdona DEMIRAJ 	“GTS Sh.p.k” 
Datë	16/05/2016		

*Shënim mbi të drejtën e autorit:

Ky document mbrohet në n kuadrin ligjor: Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012.

Ligjin nr. 9380 datë 28.04.2005 si dhe ai i vitit 2016 me të njëjtin emertim ligji “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, në ni 20 dhe 25 i këtij Ligji, si dhe kuadrin ligjor të ndryshuar së fundmi.

Ky ligj është hartuar në përputhje me direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të BE- së sa më poshtë : 1 Direktiva 2006/115 /EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi të drejtën e shitjes dhe të drejtën e hua-qirasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale (versioni i kodifikuar); 2 Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 dhjetorit 2006 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të (versioni i kodifikuar); 3 Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 29 prillit 2004 “Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”; 4 Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 majit 2001 “Mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në shoqërinë e informacionit; 5 Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 shtatorit 2001 mbi të drejtën e rishitjes për përfitimim e autorit të një vepre origjinale arti; 6 Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 marsit 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazës të të dhënave; 7 Direktiva 2009/24/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 prillit 2009 mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike (versioni i kodifikuar); 8 Direktiva 93/83/EEC mbi ritransmetimin kabllor dhe ritransmetimin satelite; 9 Direktiva 2014/26/EU e organizatave të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me të.

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Të përgjithshme	4
1.1	Hyrje	4
1.2	Kuadri ligjor në të cilin bazohet studimi	4
1.3	Objektivat e studimit.....	5
1.3.1	Objektivat afatshkurtra të VNM – së janë:	5
1.3.2	Objektivat afatgjatë të VNM – së janë:	5
2	Qëllimi i aktivitetit.....	6
2.1	Vëndet alternative të ndërtimit / instalimit të impiantit.....	6
3	Përshkrimi fizik i vëndit ku do zbatohet projekti.....	7
3.1	Të dhënat gjeografike	8
3.2	Të dhënat gjeografike kadastrale	8
4	Materialet/substancat dhe skema teknologjike e Impiantit.....	10
4.1	Përshkrimi i projektit.....	10
4.2	Informacion rreth impiantit të SO ₂	10
	Lëndët e para, ato ndihmëse dhe të produktit.....	10
4.2.1	Squfuri	10
4.2.2	Oksigjeni	10
4.2.3	Glicerina me formule kimike CHOH (CH ₂ OH) ₂	10
4.2.4	Dyoksidi i SqufuritSO ₂	10
4.3	Kapacitetet prodhuese të impiantit	11
4.3.1	Përshkrimi i pajisjeve të skemës teknologjike.....	11
4.3.2	Proçesi i prodhimit të dyoksidit të Squfurit (SO ₂)	13
4.3.3	Furnizimi me energji.....	14
4.4	Detaje teknike	15
5	Informacioni mbi zonën.....	16
5.1	Statistika të zones.....	16
5.2	Infrastruktura rrugore	16
5.3	Përshkrimi fizik-gjeografik i terrenit.....	17
6	Ndërveprimi me mjedisin	18
6.1	Analiza dhe menaxhimi i riskut.....	18
6.2	Zonat e konsideruara me ndjeshmeri	19
6.3	Ndikimet në shëndetin e njerëzve dhe kafshëve	19
6.4	Ndikimet në toka	20
6.5	Ndikimet në ujërat sipërfaqesore.....	20
6.6	Ndikimet në vegjetacion	20
6.7	Ndikimet në biodiversitet (flora dhe fauna)	21
6.8	Ndikimet nga zhurmat	21
6.9	Ndikimet në peisazh.....	21
7	Plani i menaxhimit dhe monitorimit	22
8	Konkluzionet.....	23
9	Shtojca 1	24
9.1	Hartat Set të Koordinatave të Objektivit në studim në Gauss Kruger Pulkovo 1942 dhe UTM	24
9.2	Planimetria e impiantit të prodhimit dhe ambllazhimit të Gazit SO ₂	24



9.3	Skema teknologjike e reparitit të SO ₂ të lëngët	24
10	REFERENCAT	25

Lista e Figurave:

Figura 1:	Pamje e vëndodhjes së Objektivit G.T.S Sh.p.k (Google Pro Reference Base).....	7
Figure 2:	Harta e planifikimit territorit dhe treguesi objektivit lidhur me legjendën.....	8
Figura 3:	Harta treguese e truallit të objektivit.	9
Figura 4:	Rrjeti Lokal i Infrastrukturës së Rrugëve.	17
Figura 5:	Pamje e jashtme e magazinës së impiantit. (Autor: S. Sulçe-Maj 2016)	17
Figura 6:	Harta Hidro-geologjike e zonës së projektit.....	18

Lista e Tabelave:

Tabela1:	Limitet e pozicionit gjeografik të objektivit.....	8
Tabela2:	Tretshmeria e gazit sulfuror në ujë e shprehur në % në temperatura të ndryshme.....	11

Shkurtime:

AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
BOD	Nevoja Biologjike për Oksigjen
GTS	Gazra Teknike Shqipëtare Sh.P.K.
KRT	Këshilli Rregullimit të Territorit
MP	Mineralizimi i Përgjithshëm
NIPT	Numri Identifikimit Personal Tregtare
PPV	Plani Përgjithshëm Vendor
RCRD	Research Center for Rural Development (Qendra Kërkimore për Zhvillim Rural)
UN	Uji Nëntokësor
U.P.TH.N	Uzina Përpunimit të Thellë të Naftës
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

1 Të përgjithshme

1.1 Hyrje

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të subjektit “ GTS – GAZRA TEKNIKE SHQIPËTARE SH.P.K.”, me administrator Z/Znj. BESNIK HALILI dhe NIPT: J61905015B. Ky subjekt, paraqitet si aksioner i vetëm i cili do zhvillojë aktivitetin e prodhimit e Dyoksidit të sqfurit (SO₂), pastrimin e tij dhe ambllazhimin në bombulat përkatëse.

Objekt i vlerësimit të këtij raporti është nxjerra dhe vënia në dispozicion të subjektit si dhe Ministrisë së Mjedisit dhe të gjithë grupeve të interesit sipas Legjislacionit Shqipëtar të ndikimeve negative dhe pozitive tëndërtimit të impiantit të prodhimit SO₂ në bombulat përkatëse.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u përgatit nga Research Center for Rural Development – RCRD, me numër NIPT K71630039N e themeluar në vitin 1996, me eksperiencë 12 vjecare në Vlerësimin dhe Auditimin Mjedisor për llogari të klienteve privatë dhe publikë në investime të mëdha dhe të mesme (TAP, Devolli HPPs, Ashta HPPs, Mati HPPs, Bajkaj Landfill, Saranda waste water treatment Plant, Himara Transfer Station). Studimi u relizua nga Z. Sulejman Sulce, Prof.Dr., Drejtor ekzekutiv i Qendrës dhe MSc. Erdona Demiraj, Ph.D. student.

1.2 Kuadri ligjor ne te cilin bazohet studimi

Ky raport hartohet bazuar në legjislacioni mjedisor Shqipëtar (i cili është përafuar me atë Evropian) për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe të parandalojë ose minimizojë ndikimet në mjedis të këtij projekti.

Bazuar në Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011“ **PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS**”, **Projekti që propozojmë i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.**

SHTOJCA I

PIKA 6. Instalime të integruara kimike, domethënë instalime për prodhimin në shkallë industriale të substancave që përdorin proceset e shndërrimit kimik, ku shumë njësi janë vendosur përballë njëra-tjetrës dhe janë të lidhura funksionalisht me njëra-tjetrën për:

b) prodhimin e kimikateve bazë inorganike;



1.3 Objektivat e studimit

1.3.1 Objektivat afatshkurtra të VNM – së janë:

- Përmirësimi nga pikepamja mjedisore të objektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe në efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vëndndodhjes së projektit;
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar;
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrëseve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit;

1.3.2 Objektivat afatgjatë të VNM – së janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përbërës të ekosistemeve;
- Përmirëson aspektet social-ekonomike të projektit;
- Ndhmon në realizimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

2 Qëllimi i aktivitetit

Projekti i paraqitur ka për qëllim ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të një impjanti për prodhimin dhe amballazhimin e gazit sulfuror të lëngëzuar i cili, përdoret në industrinë ushqimore konkretisht në linjat e prodhimit të verërave, të prodhimit të sheqerit, niseshtes si dhe në industrinë e përpunimit të pambukut dhe të tekstileve.

Impjanti i prodhimit të rreth 400 ton SO₂/vit të presuar në gjendje të lëngët dhe do të duhet që magazinë që do të instalohet duhet të adaptohet sidomos për:

1. Krijimi i hapsirave të veçanta per: (a) impiantin prodhues, (ii) depon e sqfurit, (iii) depoziten e Oksigjenit, (iv) depoziten e karburantit dhe kaldajen, (v) depoziten e ujit, (vi) depoziten e SO₂, (vii) ambjentin e kondicionimit të SO₂ –nga gjëndja e lëngët në gjëndje të gaztë, (viii) dhomen e veshjes dhe të personelit tjetër.
2. Krijimin e kushteve ajeruese në cati dhe në muret anësore të magazines për qarkullimin natyror të gazeve të brëndshme;
3. Instalimin e pompave aspiruese të qarkullimit të ajrit;
4. Instalimin e sistemit hidrik kunder zjarrit dhe aksidenteve nga ujerat e acidifikuar në punë.
5. Ndertimin e skemes së qarkullimit të ujit industrial që përdorej për ftohjen e paisjeve të ndryshme;
6. Ndertimin e magazines së mbajtjes së sqfurit;
7. Ndertimin e paisjes për ngarkimin e sqfurit në furrë;

2.1 Vëndet alternative të ndertimit / instalimit të impiantit

Si rregull, këto lloj industrish ndërtohen larg vendeve të banuara, në zona të përcaktuara industriale. Prodhimi i SO₂ është një procedure dhe skemë teknologjike e thjeshtë (ka vetëm një procedure kimike "S+O₂=SO₂", pa kalime sekondare kimike, pa reagentë të shtuar) dhe prodhimi është modest. Energjia që në vojitet në reaksion është e vogël (179 KJ/100g substance). Zona ku do të instalohet impjanti është e kategorisë: "Zonë Industriale-Tregetare" dhe ndodhet në periferinë periurbane të Tiranës (zona industriale Vaqarr). Përzgjedhja e vendit është korrekt kërkesave të Ligjit të Planifikimit Urban.

Investitori ka kërkuar vënde alternative në zonë por nuk është lejuar për ndërtim të ri pranë rrugës nacionale (afër varrezave publike) ku zhvillon aktivitetin kryesor "Kondicionim dhe Shpërndarje të Gazeve Industriale në Shqipëri". Ky lloj gazi (SO₂) deri tani është kondicionuar dhe shërndarë në Shqipëri nga kjo Kompani duke e blerë dyoksidin e sqfurit në impjantin e prodhimit në Elbasan.



3 Përshkrimi fizik i vëndit ku do zbatohet projekti

Magazina e cila do të jetë ndertesa ku do të instalohet impianti i prodhimit të SO₂ është me permasa të mëdha 80 X 25 m, afër 2,000 m² e ndarë në 4 kapanone me nga rreth 500 m² secili. Njëri nga kapanonet (referohu shtoces 1 pika 9.2 planimetria e impiantit), i pari nga pjesa perëndimore 250 m² do të ndahet në mes duke u bere impjantin e prodhimit 125 m² dhe po kaq sipërfaqe e disponueshme per prodhim. Dimensionet e kapanonit të Njësisë së prodhimit të diokidit të sqfurit janë 25 X 10 m ose 250 m², me lartesi në kulm 8.5 m dhe në qoshe 6.0 m.

Mbulesa është prej llamarine dhe muret janë prej blloqesh të parafabrikuar me trashësi rreth 25 cm, lehtësisht të modifikueshme të : instalimin e impiantit dhe modifikime të mundeshme si ndarje, krijim hapsire për ndricim natyror dhe ajrim, sipas kërkesave mjedisore dhe në funksion të ruajtjes së shëndetit të punëtorëve, sipas kërkesave të Ligjit të cilesise së ajrit në mjedise të mbyllura.

Shtresa e kapanonit dhe vetë kapanoni përreth (në rreth 5 m në gjithë perimetrin është prej betoni të trashë deri në 40 cm që lejon disiplinimin e ujrërave sipërfaqësore në kanale. Këto kanale lidhen me një kanal drenues i cili kalon paralele me pjesën perendimore të Kapanonit dhe percjell ujërat në lumin Erzen.




Figura 1: Pamje e vëndodhjes së Objektit G.T.S Sh.p.k (Google Pro Reference Base)




Figure 2: Harta e planifikimit territorit dhe treguesi objektit lidhur me legjendën

3.1 Të dhënat gjeografike

Bazuar në kriterin për pozitën gjeografike të objektit, janë paraqitur koordinatat e objektit në 4 skajet e strukturës së ndërtesës.

Tabela1: Limitet e pozicionit gjeografik të objektit.

Pika	Koordinatat e objektit në sistemin GAUSS KRUGER (ZONA 4)	
	X	Y
1	41.2913737°N	19.756181°E
2	41.2916012°N	19.7552746°E
3	41.2899266°N	19.7555021°E
4	41.2901601°N	19.7545844°E

3.2 Të dhënat gjeografike kadastrale

Sipërfaqja ku shtrihet objekti G.T.S sh.p.k ka një truall¹ prej 5000 m², nga ku 3000 m² është sipërfaqja e objektit të ngritur. Struktura e objektit e cila zë 60% të sipërfaqes truall do të përdoret për infrastrukturen teknologjike e cila përbehet nga rrjet tubacionesh që komunikojnë me çisternat. Duke qenë se infrastruktura e objektit shtrihet në pjesen më të madhe aksesit hyrjes në sheshin para hyrjes në objekt përben në koncept multifunksionalitetin e aktiviteteve ditore brënda sipërfaqes. Lënda e parë dhe produkti, janë ndër elementët të cilët

¹. Referuar materialit grafik “Çertifikata e pronësise” Shtojca 1 ne fund te Raportit.



kërkojnë territor dhe sipërfaqe të caktuar, brënda sipërfaqes totale të sheshit ku subjekti ushtron aktivitetin.




Figura 3: Harta treguese e truallit të objektit.

4 Materialet/substancat dhe skema teknologjike e Impjantit

4.1 Përshkrimi i projektit

Prodhimi i dyoksidit të sqfurit (SO₂) realizohet nga djegia e sqfurit të ngurtë në prani të oksigjenit me tepicë, në një furrë të specializuar për këtë qëllim dhe, më tej me mbledhjen, pastrimin dhe komprimimin e dyoksidit të sqfurit (SO₂) duke e kthyer atë nga gjëndja e gaztë, në të lëngët për t'a ambalazhuar në bombula të përshtatshme për ruajtje e transport, në këtë mënyrë sigurohet një produkt me parametra cilësor fiziko-kimik të pranuar në tregun vëndas dhe atë të huaj.

4.2 Informacion rreth impjantit të SO₂

Lëndët e para, ato ndihmëse dhe të produktit

4.2.1 Sqfuri

- Densiteti relativ 2.07gr/liter
- Temp. Shkrirjes 112.8°C
- Temp. Vlimit 444.6°C
- Tretet me tretës të ndryshëm organik si bromuri i etilenit, aceton, benzin, toluol, dikloretanglicerine, etj.
- Sqfuri gjatë djegies formon gaz sulfuror. Avujt e sqfurit me ajrin formojnë përzierje eksplozuese. Kontakti me oksiduesit është i rrezikshëm. Vatra e zjarrit shuhet me ujë dhe rërë.

4.2.2 Oksigjeni

- Densiteti 1,429
- Pesha specifike 1,1
- T.sh.k - 218,8

4.2.3 Glicerina me formule kimike CHOH (CH₂OH)₂

- Pesha molare M=92.1
- Densiteti në 0 °C dhe 760 mmkHg δ=1.23
- T.sh.k në presion 760 mmkHg 18.6 °C
- Tretshmeria në ujë infinit

4.2.4 Dyoksidi i Sqfurit SO₂

- Pesha molekulare M=64.063
- Densiteti në 0° C dhe në 760 mmkHg δ=2.926
- Pesha specifike d=2.264
- t.sh.k në presion 760 mmkHg-72.7°C
- t.v. në presion 760 mmkHg-10.08°C
- t_k temp kritike 157.5°C



- ρ_k presion kritik 77.7atm
- ρ_k densiteti kritik 0.52kg/liter
- Tretshmeria në ujë %

Tabela2: Tretshmeria e gazit sulfurore në ujë e shprehur në % në temperatura të ndryshme.

Temperatura °C	0°C	10°C	20°C	30°C	40°C
Tretshmeria %	79.8	22.8	16.239	11.327	7.818

*Gazi sulfurore është helmues në koncentrimet me të larta së 0.02 mg/liter

Gazi sulfurore nuk digjet apo vetendizet. Ai ruhet në ene celiku në ambiente të ventiluara jashtë kontaktit me lëndë oksiduese.

4.3 Kapacitetet prodhuese të impiantit

Kjo linjë ka një kapacitet prodhues 200 kg/h të produktit të gatshëm boksidit të sqfurit (SO₂) të lëngëzuar dhe të depozituar nën presion. Nivelet e prodhimit, krahas të tjerash, kondicionohet edhe nga kërkesat e tregut të brendshëm apo të jashtëm për këtë produkt.

Për çdo (kg) gaz të prodhuar konsumohet 1-1.2 kg sqfur dhe 2-2.4 kg oksigjen. Impjanti ka një fuqi elektrike të instaluar prej rreth 100 kwh dhe konsumon rreth 1.6 m³/dite ujë industrial që shërben për ftohej e paisjeve dhe larjen e ambienteve të punës, ambienteve hidrosanitare, etj. Ekesperienca e punës së këtij subjekti ka treguar që ai punon me porosi të konsumatorit të huaj, për një periudhë rreth 25-30 % të periudhës vjetore të mundshme.

Për prodhimin e gazit sulfurore (SO₂) të lëngëzuar përdoret procesi i oksidimit të sqfurit me cilësi të lartë termike, (i cili prodhohet në U.P.TH.N Ballsh), me oksigjen të paster (rreth 98.2 %). Oksigjeni i nevojshëm furnizohet me anë të bombulave përkatëse të TIPIT "G"d.m.th bombula që kanë presion të punës deri në 6 kg/cm² që vjen nga fabrika e prodhimit të oksigjenit e ish Kombinatit Energjistik Elbasan.

Bombulat e gazit ngjyra e shkrimit,ngjyra e shiritave, tipi bomemir i gazit nënshkrim Tipi G e zezë e bardhë e verdhë "Anhidrit sqfuror".

4.3.1 Përshkrimi i pajisjeve të skemës teknologjike

Linja e prodhimit të gazit sqfuror të lëngëzuar (SO₂) përbëhet nga paisje e nyje teknologjike të lidhura në mënyrë organike me njëra – tjetrën duke plotësuar kështu një linje të plotë teknologjike e aftë për të realizuar qëllimin për të cilin është projektuar. Kjo linjë teknologjike, e cila paraqitet në skemën bashkangjitur këtij raporti (Shih materialin grafaik te shtojca1), përbëhet nga:

4.3.1.1 Magazina e Sqfurit

Është një ambient i hapur me sipërfaqe rreth 270 m² që gjëndet në anën jug – lindore, rreth 15 – 20 m larg objektit kryesor të prodhimit, e vendosur në kaponon të mbulluar me llamarinë.



4.3.1.2 Furra e prodhimit të dyoksidit të Sqfurit (SO₂)

Furra ka vëllim të punës rreth 9.5 m³ dhe përmbledh në vetvete këto agregate kryesore:

A - Ushqyesin e furrës me sqfuri të ngurtë, paisje kjo e vendosur në pjesën e sipërme të furrës. Këtu realizohet procesi i shkrirjes së sqfurit të ngurtë dhe i futjes së sqfurit të shkrirë në furrë.

B - Nyja e futjes së oksigjenit, e vendosur kjo, në pjesën e përparme të furrës.

C - Sistemi i aspirimit natyral të furrës. Ky sistem largon për në atmosferë sasinë e avujve të dyoksidit të sqfurit (SO₂) që krijohet gjatë procesit të shkrirjes pra të oksidimit të sqfurit me oksigjenin e ajrit.

D - Agregatin e ngarkimit të sqfurit të ngurtë në ushqyesin e furrës. Duhet theksuar që procesi i ngarkimit të sqfurit të ngurtë në furrë është një proces gjysëm i mekanizuar.

4.3.1.3 Kapasi i piklave, filtri me gezhoja (Unaza Rushing)

Ky filter shërben për pastrimin e imët përfundimtar të dyoksidit të sqfurit (SO₂), para komprimimit (lëngëzimit) të tij. Sejcila nga paisjet ka një vëllim të përgjithshëm nga 0.6-1.7 m³.

4.3.1.4 Filtri me rrjetë metalike.

Do të instalohen tre filtra një për çdo kompresor, këto filtra kanë një volum relativisht të vogël të punës së tyre dhe kjo sepse gazi tashme ka kaluar të gjitha paisjet filtruese. Investitori do të vendosë këto filtra më shumë si masë mbrojtëse për kompresorin sesa për të arritur një shkallë më të lartë pastrimi të gazit SO₂. Në mjaft skema teknologjike të tilla nuk gjen të vendosur të tillë filtra. Duke kaluar përmes rrjetave metalike, gazi "le" aty bulëzat të lëngut si dhe grimca të ngurta.

4.3.1.5 Kompresorët e gazit

Në këtë linjë teknologjike do të instalohen tre kompresorë dy shkallësh me pistona. Duke punuar zakonisht njëri prej tyre. Për të ruajtur nivelin e temperaturës së gazit, si një tregues teknologjik i rëndësishëm gjatë ngjeshjes së tij, bëhet alternimi i vënies në punë të tyre.

Kompresori shërben për rritjen e presionit të gazit, për t'a përgatitur atë për lëngëzim nëpërmjet ftohjes së menjëhershme në ftohësin pasardhës. Presionet e punës normale të kompresorit janë të mjaftueshëm në kufinjte 4-5 bar. Prodhimtaria e një kompresori është në 8 m³/ore.

4.3.1.6 Filtri i vajit

Çdo njëri prej kondesoreve në dalje të tij është i pajisur me një filter të pajisur me rrjeta metalike. Ky tip filteri shërben për ndarjen e fazës së lëngët që derivon nga komprimimi i dyoksidit të sqfurit (SO₂). Filtri ka një vëllim prej 0.2 m³.



4.3.1.7 Ftohësi (kondensuesi) i gazit (SO₂)

Është ndër paisjet kryesore që realizon lëngëzimin e gazit, proces që realizohet nëpërmjet ftohjes me ujë industrial në mënyrë indirekte dhe rrymë të kundërt. Në këtë linjë do të instalohen dy ftohës me rrymë të kundërt d.m.th gazi rrjedhë në drejtim të kundërt me rrjedhën e ujit ftohes, të cilët kanë keto përmasa gabarite: diametër 0.8 m dhe gjatësi 1.8 m.

4.3.1.8 Rezervuarët e produktit të gatshëm (SO₂)

Janë paisje të cilat realizojnë në kushte sa më të përshtatshme depozitimin e më pas shkarkimin e produktit të gatshëm, të dyoksidit të sqfurit (SO₂) për t'a ambalazhuar sipas kërkesave të tregut dhe të konsumatorëve të veçantë. Depozita e komprimimit ka një vëllim prej rreth 50 kl (kilolitër) (diametër 2.5 m dhe gjatësi 6.0 m).

Do të instalohen 4 depozita të pajisura me atrecaturat e nevojshme që vlen të permendim matësit e presionit dhe valvulat e sigurisë. Keto valvula tarohen në vlerën e presionit normal të punës dhe, mbi këto vlera, ajo në mënyrë automatike bën çfryrjen e gazit në brëndësi të depozitës.

Ato janë prodhuar prej celiku me përmbajtte të lartë mangani gjë që i jep atyre qëndrueshmerinë e kërkuar. Veç kësaj ato janë lyer me bojë e cila i mbron ato nga agjentët atmosferik.

4.3.1.9 Pincetat dhe peshorja

Janë paisje me anë të të cilave kryhet mbushja e bombulave përkatëse me gaz të lëngëzuar me treguesit cilësor të kërkuar nga tregu. Është vendosur një peshore e zakonshme mekanike, e cila peshon bombulën bosh dhe atë gjatë mbushjes me gaz. në momentin që arrin pesha e caktuar mbyllet ventilat që dergojnë gazin në bombul. “Teprica” e gazit pra, sasia që shkon në bombul dhe që mund të rrise presionin në tubat precjelles të gazit, rikthehet në rezervuar. Ky sistem ben të mundur jo vetem mbrojtjen e paisjeve por, nuk lejon edhe të shkatërrohet gazi SO₂ në atmosferë.

Kështu nuk kemi as humbje të këtij produkti dhe as ndotje të ajrit në ambjentet e punës dhe më gjërë.

4.3.2 Proçesi i prodhimit të dyoksidit të Sqfurit (SO₂)

Proçesi i prodhimit të dyoksidit të sqfurit (SO₂) lëngëzuar bazohet në realizimin e disa stadeve të përpunimit të lëndëve të para, sqfurit dhe oksigjenit. Nëpërmjet dhënies nga jashtë të energjisë termike, sqfuri kristalin shndërrohet në sqfur të shkrirë e më pas, kemi oksidimin e sqfurit të shkrirë të sublimuar, në dyoksidin e sqfurit (SO₂).

Nxehtësia termike e nevojshme për oksidimin e mëtejshme të sqfurit të sublimuar sigurohet nga proçesi ekzotermik i oksidimit të sqfurit të sublimuar në rrymën e oksigjenit të pastër sipas reaksionit në vijim:





Kjo sasi nxehtësie e çliuar është e mjaftueshme për realizimin jo vetëm të procesit të metejshëm të oksidimit të sqfurit por, edhe për shkrirjen e sqfurit kristalin.

Dyoksidi i sqfurit (SO₂) i krijuar së bashku me një sasi sqfuri të sbulimuar shkon në sublikator, ku kryhet ftohja për efekt zgjerimi. Këtu krijohet edhe ndahet sasia më e madhe e “lules së sqfurit”

“Lulja e sqfurit” largohet periodikisht nga sublimatori, nëpërmjet hapsirës së bakabortës në fund të tij. Duke bërë shkatërrimin e “lules së sqfurit” në kovën përkatëse, bëjmë rikthimin e saj në proces, drejtpërdrejt në zonën e shkrirjes së sqfurit kristalin, mbi furrë.

Dyoksidi i sqfurit (SO₂) nga sublimatori kalon në filtrin me unaza qeramike, e më pas në filtrin me glicerinë. Ketu tretet pjesa e mbetur e sqfurit në formë pluhurash dhe mjegulle që shoqëron gazin SO₂. Më tej ky gaz kalon në procesin e pastrimit nga mjegulla e glicerinës absorbuese, në kapsin e pikave dhe atë, me unaza qeramike dhe përfundimisht në filtrin meknin me rrjete metalike.

Pra, realizimi i perftimit të dyoksidit të sqfurit (SO₂) të lëngëzuar kryhet nëpërmjet pastrimit disa shkallësh të tij. Krahas procesit të pastrimit ndodh edhe procesi i ftohjes së gazit deri në nivelin e temperaturave 30 °C para futjes së tij në kompresor.

Me tej realizohet komprimimi i dyoksidit të sqfurit (SO₂) në presion 4-5 bar dhe ftohja e menjëhereshme në 18-25 °C (sipas kurbes përkatëse të lëngëzimit të dyoksidit të sqfurit (SO₂)).

Pas komprimimit, ndodh rrijta e temperaturës së gazit në kufinj të 150-200 °C, temperaturë në të cilën është e pamundur të ndodhë lëngëzimi i tij. Për të arritur lëngëzimin e gazit bëhet ftohja e tij, proces që kryhet në paisjen ftohëse, në mënyrë indirekte, me ujë me rryma të kundërta, ku arrihet një nivel temperaturë prej 30 °C i gazit SO₂ të lëngëzuar.

Nga ftohësi, gazi SO₂ i lëngëzuar shkon në rezervuarin e komprimimit e më tej në depozitat i gatshëm për ambalazhim në bombulat që përdoren enkas për këtë qëllim.

Duke theksuar që ky proces teknologjik realizohet në cikël prodhimi të panderprerë dhe në paisje të mbyllura enkas hermetikisht.

Me paisjet dhe makineritë e përshkuara më lart, realizon prodhimin e dyoksidit të sqfurit (SO₂) të lëngëzuar me pastërti mbi 99 % i konsumueshëm në tregun e jashtëm për industrinë e lehtë dhe atë ushqimore.

4.3.3 Furnizimi me energji

Furnizimi normal i punës në këtë impjant prodhimi dhe ambalazhimi të dyoksidit të sqfurit (SO₂) kondicionohet edhe nga furnizimi normal me lëndët e para si dhe me energjitë e nevojshme. Duke qënë pjese përbërëse e zonës industriale të Vaqarrit dhe për më tepër me një magazine funksionale objekti është i lidhur në mënyrë organike me rrjetin inxhinjrik egzistues të këtij rajoni.

Kjo nënkupton faktin që energjia elektrike dhe uji industrial dhe ai i pijshëm vijnë në objekt nëpërmjet rrjeteve përkatëse. Po kështu objekti është i lidhur edhe me rrjetin e kanaleve të



shkarkimit të ujrave industrial dhe ujrave të zeza. Këto dy rrjete shkarkojne në një rrjet të përbashkët i cili shkarkon në ujrat e lumit Erzen.

4.4 Detaje teknike

Në këtë impiant funksionojnë paisjet e përshkruara në vijim:

- i. Paisjet për transportit dhe ngarkimin e sqfurit në furrë (gjysëm të mekanizuara) si karro dore, autovinxh i TIPIT “pirun” etj;
- ii. Furra e prodhimit të dyoksidit të sqfurit (SO₂) me të gjitha atrecaturat e saj:

A-Ushqyesin e furrës me sqfur të ngurtë,

B-Nyja e futjes së oksigjenit,

C-Sistemi i aspirimit natyral të furrës,

D-Agregatin e ngarkimit të sqfurit në ushqyesin e furrës. (referohu shtoces 1 pika 9.3 planimetria e impiantit)

- Dhoma e sublimimit të sqfurit;
- Dy filtra me gëzhoja;
- Filtri i glicerines/ushqimore;
- Kapsi i pikave, filtri me gëzhoja;
- Filtri me rrjete metalike;
- Kompresorët e gazit;
- Filtri i vajit;
- Ftohesi (kondesuesi) i gazit (SO₂);
- Rezervuaret e produktit të gatshëm;
- Pincetat dhe peshorja.



5 Informacioni mbi zonën

5.1 Statistika të zones

Popullsia : Vaqarri është Qëndër administrative që varet nga Bashkia e Tiranës dhe objekti është në zonë industriale (të përcaktuar si e tillë me vendim të KRT që në vitin 1996), Hartimit të Planit rregullues vendor 2013 dhe duke ruajtur së fundmi të njejtin status. Popullsia në Vaqarr në vitin 2015 është pakësuar me rreth 30% krahasuar me vitin 1990 (9,200 vs 12,800 banorë, respektivisht) për shkak të levizjeve të mëdha demografike (emigracioni jashtë shtetit dhe migrimi në zonat urbane të Tiranës). Krahasuar me qendra të tjera në Shqipëri, popullsia e Vaqarrit është më e stabilizuar përgjatë 25 vjetëve të fundit për shkak të:

- a. Afërsisë me Tiranën;
- b. Kushteve më të favorshme për punësim dhe burime natyrore relativisht të mira dhe më të mira së qendrat e tjera;
- c. Afërsia me tregun e shitjes së produkteve bujqësore ;
- d. Tradita e mirë për prodhimin e perimeve-shumë të kërkuara në Tiranë.

Qëndrat e banuara të cilat afektohen nga Projekti janë Damjani (rreth 230 banorë), Fortuzaj (me rreth 80 banorë) dhe disa familje të Vaqarr Kodër (5 familje). Për rreth zonës në një reze prej 500 m. Në këtë perimter ndodhen edhe 6 ndërtesa të tjera (magazine, frigoriferë, mobileri) si dhe një park depozitash naftë.

5.2 Infrastruktura rrugore

Infrastruktura në Njësia administrative Vaqarr ku dhe përfshihet zona Damjan-Fortuzaj ka një infrastrukturë rrugore të thjeshtë dhe funksionale me dy kahe kalimi të orientuar veri-jug-veri. Rruga lidhese që fillon nga kryqezimi i Sharres në aksin e rrugës Kombinat – Ndroq² përshkon zonën duke kaluar në drejtim të Landfill-it të Sharrës, e me tej akseson me objektet civile dhe industriale që ndodhen në të dy anet e rrugës.

Rruga ka një gjatësi nga kryqezimi i Sharrës në aksin e rruges Kombinat – Ndroq deri në piken ku lidhet me Landfill-in e Sharres prej 1.2 km dhe gjërësi 7.7 m, pastaj vashdon në drejtim të lumit Erzen ku dhe lidhet me objektin në studim “G.T.S Sh.p.k” nëpërmjet rrugës dytësore e cila ka një gjatësi 0.54 km dhe gjërësi rreth 7 m. Ky segment rrugor është i asfaltuar në pjesën më të madhe të gjatësisës së tij.

². Referuar materialit grafik “Rrjeti Lokal i Infrastrukturës së Rrugëve” Shtojca 1 në fund të Raportit.




Figura 4: Rrjeti Lokal i Infrastrukturës së Rrugëve.

5.3 Përshkrimi fizik-gjeografik i terrenit

Magazina ndodhet në një terren të pjerrët (rreth 20%) por sheshi dhe vërtë magazina janë ndërtuar mbi një taracë të sheshtë dhe poshtë saj gjithë terreni është taracuar dhe forcuar me mur guri dhe beton për qellime të stabilizimit nga rreshqitjet dhe erozioni. Sipërfaqja e pjerrët është tokë bujqesore por e abandonuar. Karakterizohet nga mbi kullotja e bagëtive, sidomos të imta.

Ajo nuk kultivohet ndonse në të kaluarën (para viteve 90) ajo ishte kultivuar me drithra dhe foragjere. Nënë ndodhen dy kopshte që u perkasin dy shtepive të ndertuara: (i) e para rreth 100 m larg Kapanonit dhe (ii) tjetra me larg, rreth 350 m nga Kapanoni. Në keto kopshte/oborre janë mbjellë pemë frutore si ullinj, kumbulla, fiq dhe shegë si dhe disa sipërfaqe shumë të vogla perimesh. Në pjesën veri – lindore të sipërfaqes së pjerrët ndodhen dy liqene të vegjël (me kapacitete jo më shumë së 30 dhe 50 mije m³, respektivisht) që shërbejnë për marrje uji për përdorim industrial dhe/ose qellime ujitjeje.




Figura 5: Pamje e jashtme e magazinës së impiantit. (Autor: S. Sulçe-Maj 2016)

6 Ndërveprimi me mjedisin

Vaqarri duke qënë afer detit ndihet dhe ndikimi zbutës i tij në kushtet klimatike. Zona dallohet për klime tipike mesdhetare me dimër të butë dhe të lagësht dhe vëre të nxehtë dhe të thatë. Një faktor shumë i rëndësishëm klimatik janë ererat veriperendimore.

Perroi i Sharrës është një rrjedhë me plotë të vogël dhe pothuaj të njëtrajtëshme. Rrjedha më sipër Landfillit bashkohet me ujin që del nga Landfilli duke u përkeqësuar në nivelin e ndotësve inorganike dhe organike. Mostrat e ujit të monitoruara tregojnë së BOD, format e tretshme të makrolementëve (N, P, K dhe S) si dhe treguesit biologjike si ngarkesa mikrobike (*Total ose Fecal Coliforms*) dhe BOD janë shumë të përkeqësuar ($EC=4250 \text{ } \square \text{ mohs cm}^{-1}$; $BOD= \text{mg L}^{-1}$; $FC =6200 \text{ CFU } 100 \text{ mL}^{-1}$). Vlera të tilla janë jashtë çdo norme të ujit sipërfaqësor dhe si rregull nuk duhet të derdhen në rrjedha sipërfaqësore pa qënë paraprakisht të trajtuara.




Figura 6: Harta Hidro-gjeologjike e zonës së projektit

6.1 Analiza dhe menaxhimi i riskut

Rrisku është një fenomen që vjen si pasojë aktivitetit të njeriut me mjedisin qofshin ato me karakter negativ apo pozitiv në zonën ku krijohet ndërhyrja fizike në mjedis. një ndër risqet që duhet marrë në konsideratë në rastin e studimit të aktivitetit të prodhimit të gazit të lëngshëm të dyoksidit të Squfurit është marrë në konsideratë analiza e multirriskut (në më shumë së një segment të veprimtarisë së procesit të montimit dhe prodhimit si më poshtë:

- *Rrisku si shkak i aksidenteve teknologjike fazën e montimit dhe sidomos të prodhimit të gazit të lëngët të SO₂;*
- *Rrisku ndaj mjedisit perreth mjedisit ku është instaluar Impjanti (në përbërës të tjerë*

të magazinës multifunksionale (përqëndrim i lartë i SO₂, zjarr, eksplozion);

- Risk në mjedisin jashtë mjediseve të mbyllura (qendra të afërta banimi ose njësi të tjera industriale;
- Risk si efekt i akumuluar me industri të tjera dhe sidomos me aktivitetin e landfillit të Sharrës nga i cili prodhohet Sox si biogaz;
- Risku i keq-përdorimit të infrastrukturës.
- Risku si shkak i aksidenteve teknologjike.

6.2 Zonat e konsideruara me ndjeshmeri

Zona në fjale shtrihet në pjesen fundore të kurrizit të kodrave të Sharres, si pjesë e taracave të lugines së Lumit Erzen. E pozicionuar në të djathte të rrjedhes së lumit, aty ku Perroi i Sharres ibashkohet me Lumin Erzen në trungun kryesor të tije.

Lugina e Erzenit. Kjo e ka filluesën nga Malësia e Tiranës dhe pasi çaj në tërthorazi vargmalin Krujë – Dajt, ku formohen edhe disa gryka dhe kanione disa qindra metra të thella, përfundojnë në fushën e Tiranës, ku lugina pothuajse zhduket dhe merr pamjen e fushës. Kodrat zënë një sipërfaqe të madhe, sidomos në periferi të fushave, ku formojnë grumbuj e madje blloqe të tëra kodrinore me reliev të ulët. (50m-200m). Qyteti i Tiranës është i rrethuar pothuajse i tëri nga vargjet kodrinore si ato të Ibë – Linëz – Vaqarr – Sharrë – Arbanë – Sauk – Lundër etj.

Zona më e lartë kodrinore është ajo e Krrabës që pjesërisht i takon rrethit të Elbasanit. Në zonën kodrinore të Tiranës bën pjesë edhe ajo që quhet Rrëza e Dajtit, e cila shtrihet në rrëzën perëndimore të malit të Dajtit, nga gryka e Skoranës në Juglindje, aty ku del lumi Erzen.

Persa i perket zonave me ndjeshmeri, në lidhje me aktivitetin që do ushtrohet jemi bazuar në Planin Urbanistik të Njësisë administrative Vaqarr, ku pozicioni i vendodhjes së subjektit është teresisht konform me Planin rregullues dhe perkon me zonen Industriale – Tregtare. Në afërsi ndodhen toka bujqesore të mbjella me perime, pemishte, ullinj dhe vreshta.

Pjese e ndjeshmerise së aktivitetit në zonë mund të permenden:

- a) *Ndikimet kufitare perreth qendrave të banuara (ndonese janë më shumë së 300 m larg);*
- b) *Ndikimet në ujerat sipërfaqësore e për rrjedhojë shëndet, agro-turizem;*
- c) *Ndikimet në acidifikimin e tokave;*
- d) *Ndikimin në shëndetin e vegjetacionit*

6.3 Ndikimet në shëndetin e njerëzve dhe kafshëve

Efekti i dioksidit të sqfurit për njerëzit dhe kafshët përbëhet në thelb acarim dhe dëmtimi i mukozës për shkak të formimit të "acid sulfurous". Pragu lejuar (sipas Ligjit Shqipëtar dhe WFD 2014) për cilësinë e ajrit në përmbajtjen e SO₂ është 20 µg/m³ në mjedise të mbyllura. Për një ore ekspozim të punëtorve në Impjantin e gazit nuk duhet të kalojë vlerën 350 µg/m³ për një orë. Në shumicën e njerëzve, përqëndrimet SO₂ prej 200 µg/m³ shkakon acarim të rrugëve të frymëmarrjes.



Përqëndrimet më të larta shkaktojnë një kollë të rëndë të thatë, dhe përmbajtja e dioksidit të sqfurit mësipërme 500 µg/m³ mund të jetë potencialisht fatal nëse thithet për një periudhë prej disa minutash. Potencialisht rreziku ekziston në këtë lloj industrie por aksidentet kanë qënë të rralla (**Environmental Protection Agency, USA**). Duhet që: (i) aspirimi natyror me hapsira të mëdha të rehabilitohet në objek (magazinë, para ose paralel me instalimin e Impjantit), (ii) asprimi i fuqishëm për qarkullimin e ajrit, (iii) veshje speciale për punëtorët, (iv) gjenerator për vazhdimin e procesit dhe sidomos ventilimin të instalohet për reste të nderprerjeve të energjise, (v) trajnim i punonjësve, (vi) plan masash në rast aksidenti dhe (vii) masa të posacme për emergjencat e aksdenteve në punë.

6.4 Ndikimet në toka

Përgjigja e Mjedisit për ndotjen nga SO₂varet nga shumë faktorë. SO₂ është një gaz volatile dhe kur shkon në atmosferë, në kushtë të lageshtisë – mjegullësore reve, ai transformohet në mënyrë natyrore në SO₃ (oksidim) dhe në H₂SO₄ (acid sulfurik). Kur, me rreshjet, acidi sulfurik kthehet në tokë si rreshje ato permbliohen si « Shi acid » dhe procesi që ndodh me tokat dhe ujerat sipërfaqësorë/nëntokësorë quhet acidifikim. Acidifikimi konsiderohet ulja e pH për efekt të joneve [H⁺] dhe shpesh pH i tokës shkon nga 7.0 në më të vogël se 5.0. Disa rajone të përballen me acidifikimin më të mirë se të tjerët, që ka « ngarkesat kritike » të mëdha.

Ngarkesës kritike referohet buferitetit më të madh që një sistem ekologjik mund të përballojë para së të tregojë degradimin e matshëm. Emetimet e SO₂ nga Impjanti janë shumë të vogla për të acidifikuar mjedisin tokësor në afërsi të zones. Llogaritjet tregojnë se me prodhimin 400 ton/vit SO₂ i lëngshëm është baraz me 1.10⁻¹⁵(%) të emetimit global (sipas të dhënave të emitimit global të EPA-USA). Tokat në zonën e Projektit janë karbonatike dhe me pH ≥ 7.0. Nuk ka ndikim në pH e tokave.

6.5 Ndikimet në ujerat sipërfaqësore

Kur shiu acid bie, H₂SO₄ mund të ndikojë pyjet, si dhe liqene dhe lumenj. Duke qënë se shiu acid lëviz nëpër tokë, ajo mund të transportojë larg lëndët ushqyese jetike të bimëve me anë të reaksioneve kimike, duke paraqitur një kërcënim potencial për produktivitet të ardhmen e pyjeve dhe bimëve bujqësore. Metale helmuese siç janë alumini, kadmium dhe merkur, janë leached nga toka me anë të reagimit me acide. Nuk ka ndikim në ujërat sipërfaqësore përderisa nuk ka koncentrim të tillë që të shkaktojë në atmosfere acidifikimin e shiut.

6.6 Ndikimet në vegjetacion

Nuk ka asnjë ndikim përderisa nuk gerrmohet, nuk hapen themele dhe nuk ndërtohet. Impjanti vendoset në një magazinë egzistuese. I vetmi rrezik për tokat dhe vegjetacionin do të ishte në se nga sheshi i Impjantit gjatë larjes do të dile dhe hidhesh në mjedis, pa kontroll, uji që mund të jetë i acidifikuar. Për të parandaluar derdhje të tilla duhet që Investitori të hapë një gropë pritëse për të grumbulluar ujin e larjes dhe ti shtohet gelqere e pa shuar (CaO).



6.7 Ndikimet në biodiversitet (flora dhe fauna)

Nuk ka ndikime në flore dhe faune dhe as në zogjtë për aq kohë sa zbatohen normat e lejuara sipas Normave të lejuara për shkarkimet e gazta të industrisë³.

6.8 Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat nuk e kalojnë 50 dB në mjediset e brëndëshme. Zhurmat janë ato që vijnë nga Raktori (<40dB), furnizimi me Squfur, kaldaja, kalimi në bombula (gjatë kalimit dhe konvertimit nga gjëndja e lëngët në gjendje të gazte). Nuk ka ndikime në zhurma.

6.9 Ndikimet në peisazh

Nuk ka ndikime sepse Impjanti do të instalohet në një ndertese (magazinë) egzistuese pra shfrytëzon një infrastrukturë tashmë te ngritur si strukturë ndërtimi.

³. Ligjit shqiptar të Cilesisë së ajrit dhe shkarkimet e gazta.



7 Plani i menaxhimit dhe monitorimit

Për eliminimin dhe/ose reduktimin e ndikimeve në mjedis në Impjantin e prodhimit të dyoksidit të sqfurit një plan manaxhimi duhet të aplikohet. Përveç planit më poshtë plane veprimi të pjesëshme (si rreziku dhe manaxhimi nga aksidentet përgjatë procesit të prodhimit) dhe rregullore të brendshme të procedurave teknike për operacionet në prodhim dhe ambllazhim, pastrim dhe organizim të prodhimit dhe të ruajtjes së shëndetit të punëtorëve duhet të zhvillohen nga Investitori/prodhuesi.



8 Konkluzionet

Bazuar në diskutimin e mësipërm, gjetjet nga proçesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), duke përfshirë në këtë raport VNM, për më tepër, përparësitë e identifikuar të vëndndodhjes (të propozuar), dhe masat e propozuara lehtësuese për ndikimin në mjedis instalimi dhe operimi i Impjantit të prodhimit të SO₂ është plotësisht i justifikuar. Ndërtimi dhe funksionimi i tij nuk ka ndikime të pa kthyeshme dhe as të pa mundur për të përmirësuar komponentëtmjedisore që afektohen. Në planin strategjik të punësimit dhe shtimit të kapaciteteve prodhuese dhe eksportuese të produkteve shqiptare ky operator ekonomik është një vlerë e shtuar për rajonin e Tiranës dhe më gjërë.



9 Shtojca 1

- 9.1 Hartat Set të Koordhinatave të Objektin në studim në Gauss Kruger Pulkovo 1942 dhe UTM
- 9.2 Planimetria e impiantit të prodhimit dhe ambllazhimit të Gazit SO₂
- 9.3 Skema teknologjike e repartit të SO₂ të lëngët



10 REFERENCAT

Environmental Protection Agency (USA): website <https://www3.epa.gov/airtrends/aqtrnd95/so2.html>

Grontmij-CarlBro (2008) Interim Progress Report 1. Implementation of the National Plan for Approximation of Environmental Legislation in Albania. 25 Nov. 2008. EuropeAID/124909/C/SER/AL

Instituti Hidrometeorologjik Tiranë. (2012-arshive). Të dhëna për erën (harta të drejtimit dhe shpejtësisë për periudhën 1971-1988).

L. Selfo, S. Sulçe, S. Guri, R. Hanxhari, J. Malltezi (2013). Raport për Vlerësimin Starategjik Mjedisor të Planit rregullues të Tiranës.

Miho A., Cullaj A., Hasko A., Lazo P., Kupe L., Schanz F., Brandl H., Bachofen R., Baraj B. (2005): Gjendja mjedisore e disa lumenjve të Ultësirës Adriatike Shqiptare. SCOPES program (Swiss National Science Foundation - SNSF), FSHN, UT, Tiranë: (<http://www.fshn.edu.al/biologjia/SCOPES/007-008-Pasqyra-Content.htm>) 235 f. (me përmbledhje në Anglisht).

MoE (2009) Draft Environmental Inspectors Handbook. Grontmij-CarlBro, National Plan for Approximation of Environmental Legislation Albania. Ministry of Environmenta Forestry and Water Administration. 250 pp.

Raport i Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri (2014). Botim i Ministrisë së Mjedisit

Raport « Rrjeti Lokal i Infrastruktures së Rrugeve » (2010) materialit grafik Shtojca 1 në fund të Raportit.

S. Sulçe & E. Demiraj (2015). ESIA rerouting TAP addendum, 215p (six separated reports).

Sulfur dioxide: <https://www.qld.gov.au/environment/pollution/monitoring/air-pollution/sulfur-dioxide/>

Sulfur dioxide pollution-environmental impacts: <http://enviimpact.org/node/19>

Water Framework Directive: [European Commission Guidelines Website](#)

